REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180/1635
Nr. i faq. 2
Data 06/03/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/14
Datë:27.02.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 dhe nenit 40 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr.03/L-40, nenit 5 paragrafi 3.2 dhe 3.5 si dhe nenit 24 të Ligjit Nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit dhe në përputhje me Statutin e Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tijë të rregullt të mbajtur më 27.02.2026 nxjerrë:

V E N D I M

Për inicimin e procedurave për hartimin e e Planit Lokal për Veprim në mjedis

I. Miratohet inicimi i procedurave për hartimin e Planit Lokal të veprimit në Mjedis (PLVM), për Komunën e Junikut.

II. Qëllimi i këtij plani është:

- Identifikimi i problemeve kryesore mjedisore në territorin e Komunës së Junikut,
- Përcaktimi i prioriteteve për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit,
- Planifikimi i masave dhe aktiviteteve konkrete për menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit,
- Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtja e burimeve natyrore.

III. Për koordinim dhe hartimin e planit do të formohet Grupi punues Komunal, i përbërë nga përfaqësues të drejtorive komunale përkatëse, institucioneve relevante, shoqërisë civile dhe ekspertëve të fushës së mjedisit.

IV. Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit në mjedis do të përfshijë:

- Analizën e gjendjes aktuale mjedisore në Komunë,
- Identifikimin e problemeve dhe prioriteteve mjedisore,
- Konsultime publike me qytetarët dhe palët e interesit,
- Hartimin e planit të veprimit me masa, projekte dhe afate kohore për zbatim.

V. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Junikut, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe planifikim hapësinor, e cila do të koordinojë procesin e hartimit të planit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i Komunës së Junikut,
- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe planifikim hapësinorë,
- Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
- Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Ljolluni